

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **UNIVERSITETI PUBLIK KADRI ZEKA**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **2026/208/97700-26-2458-2-1-1/B05-0007218**

Sa i përket tenderit për **Sigurimi fizik i objektit të UKZ-së**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Besa Security Sh.p.k

Emshir, Rr. Jusuf Gërvalla nr. 64, Prishtinë

Prishtine, 10 000

+383 49 738 267

Granit SOGOJEVA

prokurimi@besasecurity.com

16.06.2026



(Nënshkrimi dhe vula)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi per kontrate publikuar 24.04.2026
Afati i dorezimit te tendereve 15.05.2026
Procesverbali i hapjes 15.05.2026
Njoftimi mbi vendimin e AK 05.06.2026
Kerkese per rishqyrtim 08.06.2026
Refuzimi i kërkesës per rishqyrtim 08.06.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Ne kemi bere kerkese per rishqyrtim tek AK me date 08.06.2026, e njejta na u refuzua ne po te njejten dite.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 7 i LPP - Barazia ne trajtim/Jo-diskriminimi
Neni 59 i LPP - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
Neni 56.3 i LPP - Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënie e Kontratave
Neni 62 i LPP - Perfundimi i aktivitetit te prokurimit
Neni 61.3 dhe 63.2 i Rregullores per Prokurimin Publik

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Ne, OE **BESA SECURITY SH.P.K.**, paraqesim këtë ankesë në OSHP ndaj vendimit të Autoritetit Kontraktues **Universiteti Publik “Kadri Zeka”**, me të cilin jemi eliminuar nga procedura e prokurimit, duke e konsideruar vendimin tërësisht të pabazuar në fakt, të kundërligjshëm dhe në kundërshtim të drejtpërdrejtë me Ligjin për Prokurimin Publik.

1. Kërkesat e Dosjes së Tenderit

Në Dosjen e Tenderit, respektivisht ne Ankesin 1 te Dosjes se Tenderit në kuadër të specifikimeve teknike, është përcaktuar si vijon:

Pagat:

- 4 punëtorët fizik do të paguhet me pagë bruto 500.00 Euro;
- Mbikëqyrësi (njëri prej punëtorëve fizik) do të paguhet me pagë bruto 550.00 Euro dhe do të punojë gjatë ditëve të punës nga e Hëna deri të Premten, nga ora 08:00 –

16:00;

Kërkesa shitesë:

- Operatorët ekonomik duhet të paraqesin analizë financiare të detajuar për kostot mujore dhe vjetore, duke përfshirë të gjitha kërkesat e dokumentit të tenderit.

2. Arsyeja e eliminimit sipas AK

Pas analizimit të deklaratës mbi pagën dhe analizës financiare të operatorit ekonomik Besa Security SH.P .K., komisioni ka konstatuar se operatori ekonomik, megjithëse në deklaratë ka deklaruar se paga brute për rojen do të jetë 500.00 euro, në tabelën financiare ka kalkuluar pagën brute mujore në shumën prej 528 .00 euro.

Kjo vërehet në tabelën financiare të operatorit ekonomik, ku është paraqitur:

Paga Bruto Rojet në rotacion për orar të rregullt - 528.00 euro".

Ndërsa sipas analizës së Autoritetit Kontraktues, paga baze është kalkuluar në shumën fikse prej 500.00 euro, në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit.

Komisioni vlerësues konsideron se paga baze prej 500.00 euro ka qenë kërkesë fikse e dosjes së tenderit dhe si e tillë nuk ka mundur të ndryshohet apo të rritet nga operatori ekonomik gjatë përgatitjes së ofertës financiare.

Shtesat ligjore për:

- punën gjatë natës,
- punën gjatë vikendëve,
- punën gjatë festave zyrtare,
- si dhe pushimin vjetor,

duhej të kalkulohej mbi pagën baze fikse prej 500.00 euro dhe jo duke e rritur paraprakisht pagën baze në 528.00 euro.

Komisioni ka konstatuar se rritja e pages baze ka ndikuar drejtperdrejt në:

- kontributin pensional,
- kalkulimin e shtesave ligjore,
- TVSH-në,
- si dhe në koston totale të kontratës.

Nga analiza financiare rezultojnë: Analiza mujore:

- Kosto mujore sipas UKZ-se: 3,358.52 euro
- Kosto mujore sipas Besa Security: 3,529.07 euro
- Diferenca mujore: 170.55 euro

Analiza për periudhën 36 mujore:

- Totali sipas UKZ-se pa TVSH: 120,906.65 euro
- Totali sipas Besa Security pa TVSH: 127,046.56 euro
- Diferenca pa TVSH: 6,139.91 euro

MeTVSH:

- Totali sipas UKZ-se: 150,146.32 euro
- Totali sipas Besa Security: 157,391.42 euro
- Diferenca totale: 7,245.09 euro

Pra, Autoriteti Kontraktues ka eliminuar ofertën tonë me arsyetimin se:

- Në deklaratë kemi deklaruar pagën bruto për rojen 500.00 Euro;
- Ndërsa në analizën financiare kemi kalkuluar pagën bruto mujore 528.00 Euro;
- Sipas AK-së, paga prej 500.00 Euro është kërkesë fikse e Dosjes së Tenderit dhe nuk mund të ndryshohet;
- Kjo ka ndikuar në kalkulimin e kontributeve pensionale, shtesave ligjore, TVSH-së dhe kostos totale;
- AK ka konstatuar se nuk bëhet fjalë për gabim aritmetik, por për ndryshim substancial të strukturës së kostos financiare;
- Si rezultat, oferta jonë është konsideruar jo në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit.

3. Kundërshtimi ynë

Arsyetimi i Autoritetit Kontraktues është i pabazuar dhe në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik dhe vetë Dosjen e Tenderit, për arsytet në vijim:

3.1. Paga 500.00 Euro nuk është kufi maksimal apo i pandryshueshëm

Në asnjë pjesë të Dosjes së Tenderit nuk është përcaktuar se paga prej 500.00 Euro është shumë fikse, maksimale apo e ndaluar për t'u tejkaluar. Kjo shumë përbën minimumin e kërkuar që duhet respektuar, **jo kufizim për ndalimin e pagesave më të larta.**

Ne kemi deklaruar qartë se do të respektojmë kërkesën e AK-së për pagën 500.00 Euro. Përfshirja e shumës shtesë prej 28.00 Euro në analizën financiare nuk përbën ndryshim të kërkesës së DT-së, por paraqet vetëm **përmirësim të kushteve të punësimit.**

3.2. Analiza financiare nuk është kriter eliminues

Analiza financiare e kërkuar në Dosjen e Tenderit nuk është kriter kualifikimi dhe as kriter për përgjegjshmëri. Ajo shërben vetëm për të dëshmuar mënyrën e kalkulimit të kostove.

3.3. AK ka kryer kalkulim të vet financiar – tejkalim kompetencash

Nga vetë arsyetimi i AK-së rezulton se komisioni vlerësues ka përgatitur një analizë të vetën financiare, duke kalkuluar kostot mujore dhe vjetore sipas interpretimit të tij dhe më pas e ka krahasuar atë me analizën tonë.

Ky veprim përbën tejkalim të kompetencave të AK-së, pasi vlerësimi duhet të bazohet vetëm në kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit, jo në modele financiare të krijuara pas hapjes së ofertave.

Pra, Autoriteti Kontraktues ka trajtuar pagën 500.00 Euro si kufi absolut dhe të pandryshueshëm. Ky interpretim përbën krijim të një kriteri të ri gjatë vlerësimit, në kundërshtim me parimin e transparencës dhe barazisë në konkurrencë.

3.4. Nuk kemi gabim aritmetik dhe as ndryshim të ofertës

AK tenton ta paraqesë çështjen si “devijim financiar”, por:

- nuk ka gabim aritmetik,
- nuk ka korigjim të ofertës,
- nuk ka ndryshim të çmimit final.

Kjo është **interpretim i gabuar juridik i një kalkulimi të brendshëm**, i cili nuk ka efekt juridik në vlefshmërinë e ofertës.

3.5. Oferta është brenda buxhetit të AK-së

Vlera e parashikuar e kontratës është **180,000.00 Euro**, ndërsa oferta jonë është **157,391.27 Euro me TVSH**, pra dukshëm më e ulët se buxheti i parashikuar.

3.6 Kontradikta e rëndë e AK-së

AK pranon vetë se ka bërë:

- kalkulim të pagës minimale sipas interpretimit të vet, dhe
- krahasim me ofertën tonë.

Kjo dëshmon se eliminimi nuk është bërë mbi bazë të DT-së, por mbi bazë të **standardeve të krijuara ex post facto**, gjë që është shkelje e rëndë e parimit të transparencës dhe barazisë në konkurrencë.

4. Shkeljet ligjore

Shkelje e nenit 7 te LPP – se

Neni 7.6 i LPP percakton qarte se: *Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit; (ii) publikimin e rregullt, dërgimin dhe/ose disponueshmërinë e të gjitha njoftimeve, ftesave, informacioneve dhe dokumenteve që kanë të bëjnë me aktivitetin e prokurimit në përputhje me këtë ligj; (iii) eliminimin e praktikave, kritereve, kërkesave dhe specifikimeve teknike që diskriminojnë në favor ose kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik; (iv) që të gjitha specifikimet teknike dhe të gjitha kërkesat për përzgjedhje dhe dhënie, duke përfshirë rëndësinë relative të secilës kërkesë dhe kriter të tillë, si dhe metodat e përzgjedhjes dhe dhënies të saktësohen në njoftimin e kontratës ose konkursit përkatës të projektimit, në ftesën për tender ose pjesëmarrje dhe/ose në dosjen e tenderit; (v) që asnjë kërkesë, kriter, specifikim që nuk është saktësuar kështu, të mos përdoret në procesin e përzgjedhjes ose dhënies, dhe (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse.*

Në rastin konkret, Autoriteti Kontraktues ka eliminuar OE BESA SECURITY SH.P.K. duke u bazuar në një kërkesë e cila nuk ekziston në Dosjen e Tenderit, respektivisht në interpretimin se paga prej 500.00 Euro përbën pagë fikse, të pandryshueshme dhe që nuk

mund të tejkalohet gjatë kalkulimit të kostove financiare.

Një kërkesë e tillë nuk është specifikuar askund në Dosjen e Tenderit, nuk është bërë e njohur për operatorët ekonomikë gjatë fazës së ofertimit dhe nuk është kriteri i perzgjedhjes. Përkundrazi, kjo kërkesë është krijuar nga komisioni vlerësues vetëm gjatë fazës së shqyrtimit të ofertave dhe është përdorur si bazë për eliminimin e ofertës sonë.

Përdorimi i kritereve të paspecifikuara në Dosjen e Tenderit cenon drejtpërdrejt parimet e transparencës, konkurrencës së drejtë dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë, duke përbërë shkelje të nenit 7.6, nënparagrafët (iii), (iv) dhe (v) të Ligjit për Prokurimin Publik.

Shkelje e nenit 56.3 të LPP-së

Neni 56.3 përcakton qartë se: *“Tenderuesi nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat në baza të ndonjë kërkesë apo kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.”*

Në këtë rast, AK ka krijuar një kriter të ri gjatë vlerësimit duke e trajtuar pagën 500.00 Euro si kufi të pandryshueshëm, gjë që nuk është përcaktuar në DT.

Në asnjë dispozitë të Dosjes së Tenderit **nuk ekziston ndalesë** që operatorët ekonomikë:

- të paguajnë më shumë se 500.00 Euro

Interpretimi i AK-së se paga 500.00 Euro është “fikse dhe e pandryshueshme” përbën **krijim të një kriteri të ri gjatë vlerësimit**, i cili nuk është publikuar në DT dhe nuk është bërë pjesë e konkurrencës.

Ky interpretim përbën **krijim të një kriteri të ri pas hapjes së ofertave**, në kundërshtim me:

- parimin e transparencës
- parimin e trajtimit të barabartë
- nenin 56.3 të LPP-së .

Interpretimi i Autoritetit Kontraktues se paga prej 500.00 Euro paraqet një vlerë fikse dhe maksimale, e cila nuk mund të tejkalohet nga operatorët ekonomikë, **bie ndesh me parimet e konkurrencës së lirë dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë**. Në një treg konkurrues, secili operator ekonomik ka të drejtë të organizojë strukturën e vet të kostove dhe të ofrojë kushte më të favorshme për punëtorët e tij, përderisa i përmbush kërkesat minimale të përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Duke e trajtuar pagën prej 500.00 Euro si kufi maksimal dhe jo si kërkesë minimale, Autoriteti Kontraktues ka kufizuar pa bazë ligjore autonominë e operatorëve ekonomikë në formimin e kostove të tyre dhe ka krijuar një kriter që nuk ka qenë i publikuar në Dosjen e Tenderit. Një qasje e tillë është në kundërshtim me nenin 7 dhe nenin 56.3 të LPP-së, të cilat ndalojnë përdorimin e kritereve të papublikuara dhe veprimet që kufizojnë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë

Nëse Autoriteti Kontraktues ka pasur për qëllim që paga prej 500.00 Euro të jetë pagë

fikse dhe e pandryshueshme, ai ka qenë i obliguar ta specifikojë shprehimisht këtë në Dosjen e Tenderit. Mungesa e një kufizimi të tillë nuk mund të plotësohet nga komisioni vlerësues pas hapjes së ofertave, pasi kjo do të nënkuptonte ndryshim të rregullave të garës pas përfundimit të afatit për ofertim.

Shkelje e nenit 59 të LPP-së – Vlerësimi i tenderëve

Autoriteti Kontraktues nuk ka bërë vlerësim të ofertës sipas kritereve të Dosjes së Tenderit, por:

- ka ndërtuar vetë një model kalkulimi financiar,
- ka krijuar “analizë krahasuese të brendshme”,
- dhe më pas e ka përdorur atë si standard për eliminim.

Ky veprim është **i paligjshëm**, pasi neni 59 obligon vlerësimin strikt mbi bazën e kritereve të publikuara paraprakisht, jo mbi modele të brendshme të AK-së.

Për më tepër, duhet theksuar se vlera e parashikuar e këtij aktiviteti të prokurimit është **180,000.00 Euro**, ndërsa oferta e OE BESA SECURITY SH.P.K. është në vlerë prej **157,391.27 Euro me TVSH**, respektivisht rreth **22,608.73 Euro më e ulët** se vlera e parashikuar nga Autoriteti Kontraktues.

Ky fakt dëshmon qartë se kalkulimet e paraqitura në analizën tonë financiare, përfshirë edhe parashikimin e një page më të lartë për punëtorët, nuk kanë ndikuar në tejkalimin e buxhetit të Autoritetit Kontraktues dhe nuk cenojnë në asnjë mënyrë realizueshmërinë ekonomike të kontratës.

Përkundrazi, oferta jonë mbetet brenda kufijve të buxhetit të parashikuar, është financiarisht e qëndrueshme dhe siguron realizimin e plotë të kontratës sipas kërkesave të Dosjes së Tenderit. Për rrjedhojë, pretendimi i Autoritetit Kontraktues se kalkulimi ynë financiar përbën devijim substancial nuk mbështetet në asnjë pasojë reale financiare apo juridike për aktivitetin e prokurimit.

Madje, edhe sipas analizës së vet Autoritetit Kontraktues, diferenca e pretenduar prej 7,245.09 Euro me TVSH nuk e afron ofertën tonë me kufirin e buxhetit të parashikuar dhe nuk krijon asnjë rrezik për realizimin e kontratës. Përkundrazi, oferta jonë vazhdon të mbetet dukshëm nën vlerën e parashikuar prej 180,000.00 Euro, gjë që rrëzon arsyetimin e Autoritetit Kontraktues se kemi paraqitur një ofertë jo të pranueshme apo jo në përputhje me kërkesat e tenderit.

Shkelje e nenit 62 të LPP-së – Përfundimi i aktivitetit

Neni 62 përcakton:

1. Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:

1.1. **një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit**, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.

2. Autoritetet kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:

2.1 të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e

autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit;

Nuk ekziston bazë ligjore për anulim të procedurës, pasi:

- **oferta jone është e përgjegjshme**
- **oferta është brenda buxhetit të AK-së**

Shkelje e nenit 61.3 dhe 63.2 i Rregullores:

Më datë 06.08.2026 kemi parashtruar Kërkesën për Rishqyrtim, dhe po në të njëjtën ditë kemi pranuar Vendimin mbi refuzimin e saj. Megjithatë, Autoriteti Kontraktues nuk e ka publikuar as Kërkesën për Rishqyrtim dhe as Vendimin përkatës në Platformën e Prokurimit Elektronik, në dosjen e tenderit, si “Dokument shtesë”.

Me këtë veprim është shkelur neni 61.3 i Rregullores, i cili obligon Autoritetin Kontraktues që Kërkesa për Rishqyrtim të publikohet në platformë dhe të trajtohet brenda afatit ligjor, si dhe neni 63.2, i cili përcakton obligimin për publikimin e vendimit mbi miratimin ose refuzimin e kërkesës në sistemin e prokurimit elektronik.

61.3 Autoriteti Kontraktues, respektivisht Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit, do të publikojë Kërkesën për rishqyrtim në Platformë tek dosja e tenderit në “shto dokument shtesë” dhe do ta shqyrtojë kërkesën brenda tre (3) ditë pune nga data e parashtrimt të kërkesës, kur është e zbatueshme, nga data e marrjes së informatave shtesë dhe dokumenteve të parashikuara në nenin 60.2 të kësaj rregullore. Ky afat, në raste specifike të justifikuara mund të zgjatet për jo më shumë se tre (3) ditë shtesë, dhe ankuesi do të informohet për këtë.

63.2. Vendimi mbi refuzimin ose miratimin është obligativ dhe do të publikohet në sistem të prokurimit elektronik si “Dokument shtesë” tek dosja e tenderit nga Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit. Në rastet kur zyrtari Përgjegjës i Prokurimit nuk nxjerrë vendim në lidhje me kërkesën për shqyrtim dhe nuk njofton operatorin ekonomik për afat shtesë, Operatori Ekonomik ka të drejtë që të parashtror një ankese pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit pas skadimit të afatit prej 3 (tre) dite pune nga data e dorëzimit të kërkesës për rishqyrtim. Në kalkulim të afateve kohore data e dorëzimit të kërkesës për rishqyrtim është dita (0).

5. Përfundim

Bazuar në sa më sipër, konstatohet se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim të drejtpërdrejtë me:

- **Nenin 56.3 të LPP-së** – ndalim i eliminimit mbi kritere të papërcaktuara në DT;
- **Nenin 59 të LPP-së** – vlerësim jashtë kritereve të publikuara;
- **Nenin 62 të LPP-së** – mungesë e bazës ligjore për eliminim apo përfundim procedure.

Eliminimi i OE BESA SECURITY SH.P.K. është rrjedhojë e një interpretimi arbitrar, të paargumentuar dhe juridikisht të paqëndrueshëm, i cili cenon në mënyrë të drejtpërdrejtë parimet themelore të prokurimit publik.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Autoriteti Kontraktues nuk ka zbatuar dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik, gjë që ka shkaktuar pasoja të drejtpërdrejta materiale, përfshirë:

- Kostot e përgatitjes së ofertës dhe dokumentacionit mbështetës;
- Dëmin ekonomik të shkaktuar nga humbja e një kontrate të mundshme;

Për këto arsye, duke u mbështetur në Ligjin për Prokurimin Publik dhe rregulloren përkatëse, kërkojmë nga OSHP që të obligojë Autoritetin Kontraktues që:

1. **Të anulojë Njoftimin mbi Vendimin e datës 05.06.2026;**
2. **Të kthejë çështjen në procedurë të ri-vlerësimit;**
3. **Të shpallë ofertën tonë fitues te tenderit.**

Kjo kërkesë është në funksion të respektimit të parimeve të transparencës, proporcionalitetit dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) *një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) *një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) *bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
- f) *Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe*
- g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*